



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

SYLLABUS i Lëndës Analiza Statistikore

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Analiza Statistikore
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II (semestri IV)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda "Analiza statistikore" përfshin trajtimin e çështjeve ekonomike, përmes metodave dhe teknikave me të cilat mund të bëhet analiza statistikore e fenomeneve të ndryshme ekonomike dhe shoqërore. Lënda do të trajtojë më gjerësisht teorinë e probabilitetit dhe distribucionet teorike duke vënë theksin te shpërndarja normale. Gjithashtu do të trajtohen metodat përmes të cilave bëhet vlerësimi i parametrave të tërësisë së përgjithshme përmes mostrës : si intervalet e besimit dhe testimi i hipotezave. Rëndësi do të kushtohet analizës së regresionit dhe korrelacionit, sidomos regresionit multivariabël duke pasqyruar aplikimin e shumtë të kësaj metode në shumë sfera. Gjithashtu, seritë kohore do të zënë një vend të konsiderueshëm.
Qëllimet e lëndës:	Zgjerimi i njohurive të fituara në bazat e statistikës Aftësimi i studenteve për të bërë vlerësimin përmes intervaleve të besimit dhe testimit të hipotezave Aftësimi i studenteve për të përfunduar analizën e regresionit dhe korrelacionit, Zgjerimi i njohurive rreth serive kohore
Rezultatet e pritura të nxënies:	1) Kuptoj rolin dhe rëndësin e analizës statistikore për marrjen e vendimeve në

	sfera te ndryshme ekonomike, shoqërore dhe personale. 2) Bëjë vlerësimin e parametrave të tërësisë së përgjithshme përmes intervalit të besimit dhe testimit të hipotezave. 3) Vlerësoj raportet në mes të dy apo me shumë dukurive, të interpretoj rezultatet e gjetura dhe t'i aplikoj në jetën praktike/ reale		
Kontributinëgarkesën e studentit (gjëqëduhettëkorrespondoj me rezultatet e tënxënëttëstudentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125
Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 5 ECTS kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 125 orë.			
Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore përqendrohet në ligjerata dhe diskutime Interaktive me pjesëmarrje te studentëve në procesin e mësimin. Ata inkurajohen që paraprakisht të lexojnë materiale rreth temave vijuese, në mënyrë që të jenë të pregaditur për diskutime interaktive. • Do përdoren raste studimi dhe detyra për çdo njësi. • Konceptet e mësuara gjatë orëve të ligjëratave do të praktikohen përmes shembujve konkret gjatë orëve të ushtrimeve, e kohë pas kohe do të ketë demonstrime të rezultateve të hulumtimit në SPSS.		

Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë: ✓ Të vijueshmërisë dhe angazhimit të tyre në ligjerata dhe ushtrime, ✓ detyrave dhe projekteve hulumtuese ✓ suksesit në kollokviume si dhe ✓ provimit përfundimtar.
Literatura	
Literatura bazë:	Rahmije Mustafa - Topxhiu: HYRJE NË STATISTIKË, Prishtinë, 2016
Literatura shtesë:	Prem S. Man, Introductory Statistics, Seventh Edition, John Wiley & Sons, 2010, USA, Ajet Ahmeti, Statistikë për biznes dhe ekonomiks, 2016.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, Metodat e punës dhe vlerësimit)
Java e dytë:	Të dhënat, matja dhe statistika
Java e tretë:	Statistika përshkuese, metoda tabelare dhe grafike
Java e katërt:	Treguesit e variacionit dhe tregues të tjerë të përshkrimit të të dhënave
Java e pestë:	Hyrje në STATA/SPSS - Vlerësimi Intervalor
Java e gjashtë:	Variablat e rastit dhe Modelet e shpërndarjeve probabilitare- Shpërndarjet probabilitare të ndërprera
Java e shtatë:	Shpërndarja probabilitare të vazhdueshme – shpërndarja normale
Java e tetë:	Testi I
Java e nëntë:	Kontrolli i hipotezave statistikore
Java e dhjetë:	Gjykimet statistikore për mesataret dhe përpjesat e dy popullimeve dhe për variancat e popullimeve
Java e njëmbëdhjetë:	Analiza e korrelacionit linear
Java e dymbëdhjetë:	Regresioni linear
Java e trembëdhjetë:	Regresioni me shumë variabla
Java e katërmëdhjetë:	Analiza dhe prognozimi i serive kohore
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
- Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive në ligjërata dhe në ushtrime; - Respektimi i orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve. - Mbajtja e qetësisë në mësim ç'kyçja e telefonave celular.